

Nr. 1073 Prot.

Tiranë, më 25 / 11 / 2016

Drejtuar: Z. Artur Metohu
Administrator
Partner plus SHKK

Lënda: Dërgohet vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave mbi kërkesën për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave.

I nderuar Zoti Administrator,

Me anë të kësaj shkrese, Ju informojmë se më datë 24 Nëntor 2016, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, shqyrtoi kërkesën e shoqërisë së kursim-kreditit "Partner plus" për anëtarësim në skemën e sigurimit të depozitave.

Sa më sipër, bashkëlidhur gjeni vendimin e Këshillit Drejtues nr. 33, datë 24.11.2016, si dhe vërtetimin për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave.



Ju informojmë se certifikata e sigurimit të depozitave do t'iu dorëzohet në ambientet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, më datë 30 Nëntor 2016, ora 12.00. Certifikata e sigurimit të depozitave legjitimon anëtarësimin e shoqërisë "Partner plus" në skemën e sigurimit të depozitave duke filluar nga data 1 Janar 2017.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Genci Mamani

Drejtore i Përgjithshëm





V E N D I M

Nr.33, datë 24.11.2016

“Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave si dhe të certifikatës të sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus””

Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në mbështetje të nenit 4, shkronja “a”, të nenit 23, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 27, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p” dhe pika 2, të nenit 53, pika 5, shkronja “d”, të nenit 68, pika 1/2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5, nenit 6, pika 8 si dhe të nenit 41, pika 1, shkronja “b” të Udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,

V E N D O S I:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave, si dhe certifikatës të sigurimit të depozitave shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”.
2. Certifikata e sigurimit të depozitave hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.
3. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dorëzimin e vërtetimit dhe certifikatës shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”.
4. Të informohet Autoriteti Mbikëqyrës mbi këtë vendim.


Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet shoqërisë së kursim-kreditit “Partner Plus”, brenda 7 ditëve kalendarike nga miratimi i tij.

Martin Blushi

Sekretar


Donald Duraj

Kryetar



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Mbrojmë depozitat tuaja!



CERTIFIKATË

Nr. 4

PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE NË

Shoqërinë e Kursim-Kreditit **Partner plus**

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Siguron depozitat deri në

2.000.000 Lekë

sipas Ligjit "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar

Tiranë, 01.01.2017

Beaçi Tavaani
Drejtori i Përgjithshëm



Donat Pol Durrës
Kryetari i Këshillit Drejtues